



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

RAPORT

I

AVOKATIT TË POPULLIT

R. nr. 522/2024

lidhur me

Vendimin Nr.43/III/2024 të Ministrisë së Shëndetësisë, të datës 22 mars 2024, përkitazi me mbulimin e trajtimit mjekësor të personave me status të invalidit të luftës së UÇK-së

Drejtuar:

Z. Albin Kurti, Kryeministër
Qeveria e Republikës së Kosovës

Z. Arben Vitia, Ministër
Ministria e Shëndetësisë

Kopje:

Z. Habit Hajredini, Drejtor
Zyra për Qeverisje të Mirë

Prishtinë, më 5 dhjetor 2024

Qëllimi i raportit

1. Qëllimi i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes së Ministrisë së Shëndetësisë (MSH), lidhur me zbatimin e Vendimit Nr.01/194, të datës 20 mars 2024, përkitazi me mbulimin e trajtimit mjekësor të personave me status të invalidit të luftës, i nxjerrë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 6 të Ligjit nr.04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre.
2. Ky raport është i bazuar në ankesën individuale të z. Avni Lubovcit, kryetar i Shoqatës së të Plagosurve Civile nga Minat (në tekstin e mëtejme: ankuesi).

Baza ligjore

3. Kushtetuta e Republikës së Kosovës neni 135, paragrafi 3, përcakton: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”*
4. Avokati i Popullit, sipas Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, mes të tjerash, ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
 - *“të hetojë ankesat e pranuar nga çdo person fizik a juridik lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me kushtetutë, ligje dhe akte tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit.”* (neni 16, paragrafi 1);
 - *“të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla.”* (neni 18, par. 1, nënparagrafi 2);
 - *“të bëjë të njohura të drejtat e njeriut dhe përpjekjet për të luftuar të gjitha format e diskriminimit përmes ngritjes së vetëdijesimit, posaçërisht përmes informimit dhe edukimit edhe me anë të mediave”* (neni 18, par. 1, nënparagrafi 4);
 - *“të njoftojë Qeverinë, Kuvendin dhe institucionet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit”* (neni 18, par. 1, nënparagrafi 5);
 - *“t’i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta”* (neni 18, par. 1, nënparagrafi 6);
 - *“të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës.”* (neni 18, par. 1, nënparagrafi 7);
 - *“t’i rekomandojë Kuvendit harmonizimin e legjislacionit me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe liritë e njeriut si dhe zbatimin e tyre efektiv”* (neni 18, par. 1, nënparagrafi 9).

Përmbledhje e fakteve

Faktet dhe informatat lidhur me rastin, të cilat i posedon Avokati i Popullit, mund të përmblihen si në vijim:

5. Më 20 mars 2024, Qeveria e Republikës së Kosovës kishte marrë Vendimin Nr.01/194, me ç' rast kishte aprovuar kërkesën e Ministrisë së Shëndetësisë për mbulimin e trajtimit mjekësor të personave me *status të invalidit të luftës* për qëllim të ndërrimit, mirëmbajtjes apo vendosjes së protezave, jashtë institucioneve shëndetësore publike, kur këto të fundit nuk i ofrojnë këto shërbime. Më tej në vendim përcaktohet se mjetet financiare për zbatimin e këtij vendimi shfrytëzohen nga buxheti i programit për trajtim mjekësor jashtë institucioneve shëndetësore publike (FSSh). Për më tepër, vendimi obligon Ministrinë e Shëndetësisë dhe Fondin e Sigurisë Shëndetësore për zbatimin e këtij vendimi sipas legjislacionit në fuqi.
6. Më 22 mars 2024, Ministria e Shëndetësisë kishte nxjerrë Vendimin Nr. 43/III/2024, me të cilin e obligon Bordin për Trajtim Mjekësor Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike, që t'i mbulojë financiarisht ndërrimin, mirëmbajtjen apo vendosjen e protezave sipas kërkesës së përzgjedhur nga aplikuesi me rastin e aplikimit për trajtim mjekësor jashtë institucioneve shëndetësore publike, vetëm për personat që kanë *status të invalidit të luftës së UÇK-së*.
7. Arsyetimi i MSh-së ishte se duke marrë parasysh se Udhëzimi Administrativ nr.03/2023 për Trajtimin Mjekësor Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike nuk përcakton kategorinë e personave me status të invalidit të luftës së UÇK-së dhe se në zbatim të Vendimit nr.01/194, të datës 20 mars 2024, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ishte vendos si në dispozitiv të këtij vendimi (Vendimi Nr. 43/III/2024).
8. Më 12 prill 2024, ankuesi, në cilësinë e kryetarit të Shoqatës së të Plagosurve Civilë nga Minat, kishte parashtruar ankesë të Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht në Zyrën e Kryeministrit si dhe në Fondin e Sigurimit Shëndetësor (FSSh), kundër vendimeve të Bordit të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore, i cili, duke u bazuar në Vendimi nr. 01/194 të nxjerrë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, nuk i kishte marrë për bazë kërkesat e invalidëve civilë të luftës, për trajtimin shëndetësor dhe sigurimin e mjeteve të mjaftueshme për proteza, mirëpo ankuesi ka pohuar se nuk kishte marrë përgjigje.
9. Më 15 prill 2024, ankuesi kishte parashtruar ankesë edhe në Ministrinë e Shëndetësisë (MSh) kundër vendimeve të Bordit të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore, mirëpo kishte pohuar se as nga ministria nuk kishte marrë përgjigje.
10. Ankuesi me rastin e paraqitjes së ankesave drejtuar Qeverisë së Republikës së Kosovës, Fondit të Sigurimit Shëndetësor dhe Ministrisë së Shëndetësisë, është mbështetur në Vendimin Nr.01/94, të datës 20 mars 2024, si dhe nenin 6 [Benificionet e veçanta], pika 1.7, të Ligjit Nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Pjesëtarëve të UÇK-së, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre, sipas të cilit: *“Kompensimi ortopedik është e drejte e sigurimit të mjeteve ortopedike për invalidët e UÇK-së dhe invalidët civil të luftës, të cilëve u është dëmtuar organizmi nga plagosja, apo amputimi ekstremiteteve.”*
11. Ankuesi ka njoftuar se janë gjithsej 68 persona që e gëzojnë statusin e invalidit civil të luftës e që kanë nevojë për 74 proteza, pasi në mesin e tyre ka persona që kanë nevojë për

më shumë se një protezë. Prej 68 personave të kësaj kategorie, ankuesi ka njoftuar se 34 persona janë pajtuar me vendimet e Fondit të Sigurimit Shëndetësor, të cilëve u është mbuluar shuma bazë e çmimit referent, ndërsa 20 persona kane bërë ankesë, ndërsa pjesa tjetër nuk ka aplikuar ende.

12. Ankuesi thekson se invalidët civilë të luftës janë duke u ndier të diskriminuar nga MSh-ja, pasi Qeveria Republikës së Kosovës ka marrë vendim duke u mbështetur në nenin 6 të Ligjit Nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të UÇK-së, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre, i cili përcakton benificionet e veçanta edhe për **invalidët civilë të luftës**, ndërsa vendimi i MSh-së i ka paraparë këto benificione vetëm për personat me status të invalidit të luftës së UÇK-së, duke i përjashtuar kështu *invalidët civilë të luftës*.
13. Më 9 shtator 2024, përfaqësuesja e Avokatit të Popullit ka zhvilluar një takim me zyrtarët e MSh-së, me ç’ rast është njoftuar se MSh-ja është në proces të ndryshimit të Udhëzimit Administrativ 03/2023 për Trajtim Mjekësor Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike, e që aktualisht gjendet në fazën finale. Po ashtu është mësuar se MSh-ja ka kërkuar buxhet shtesë nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të bëhet implementimi i këtij akti.

Instrumentet ligjore të zbatueshme në Republikën e Kosovës

14. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 21, përcakton: “*Republika e Kosovës mbrohet dhe garanton të drejtat e njeriut dhe liritë themelore [...]*.”
15. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 24, përcakton: “*Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhje kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.*”
16. Neni 14 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj) përcakton: “*Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në Konventë duhet të sigurohet pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla, si: seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.*”
17. Neni 1 i Protokollit 12 [Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit], paragrafi 1, i KEDNj-së parashikon: “*Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër*”. Ndërsa në paragrafin 2 parashikon: “*Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsytet e parashikuara në paragrafin 1.*”
18. Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, neni 1, paragrafi 1, përcakton: “*Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i një kornize të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës,*

gjendjes familjare ose martesore, shtatëzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë.”

19. Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, neni 2, përcakton fushëveprimin, sipas të cilit: *“Ky ligj zbatohet për të gjitha veprimet apo mosveprimet, të të gjitha institucioneve shtetërore dhe lokale, të personave fizik dhe juridik, të sektorit publik dhe privat, të cilët shkelin, kanë shkelur ose mund të shkelin të drejtat e çdo personi apo personave fizik dhe juridik, në të gjitha fushat e jetës, e posaçërisht që kanë të bëjnë me kushtet për qasje në punësim, vetëpunësim dhe punësimin në profesion, përfshirë këtu kushtet e punësimit, kriteret e përzgjedhjes, pa marrë parasysh aktivitetin në të gjitha nivelet e hierarkisë profesionale, përfshirë avancimet, qasje në të gjitha llojet dhe nivelet e udhëheqjes profesionale, trajnimeve profesionale, trajnimit të avancuar profesional dhe rikualifikimet përfshirë edhe përvojën e punës praktike [...], çfarëdo të drejte tjetër të paraparë me legjislacionin në fuqi.”*
20. Ligji nr.04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre, neni 3, paragrafi 1.8, përcakton: *“Invalid civil i luftës është personi, organizmi i të cilit është dëmtuar së paku 40% si pasojë e plagëve të marra nga armët, sëmundjes së fituar në burgjet apo kampet gjatë luftës së fundit në Kosovë, prej datës 27.02.1998 deri me datën 20.06.1999, si dhe personat e tjerë, organizmi i të cilëve është dëmtuar së paku 40% si pasojë e mjeteve shpërthyes të mbetura pas përfundimit të luftës.”*
21. Neni 6, paragrafi 1.5, i Ligjit nr.04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre, përcakton: *“Shërbimet shëndetësore jashtë vendit i gëzojnë edhe **invalidët civil të luftës** për gjendjen shëndetësore të përkeqësuar, që është pasojë e luftës dhe për të cilën nuk ka shërim në vendin tonë.”*
22. Neni 6, paragrafi 1.7, i Ligjit nr.04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre përcakton: *“Kompensimi ortopedik është e drejtë e sigurimit të mjeteve ortopedike për invalidët e UÇK-së dhe **invalidët civil të luftës**, të cilëve u është dëmtuar organizmi nga plagosja, apo amputimi i ekstremiteteve.”*
23. Ligji nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në nenin 9, par. 1, nënpar. 1.6, përcakton se kryeministri: *“Nëse vlerëson se vendimi i marrë apo akti nënligjor i nxjerrë nga zëvendëskryeministri **apo ministri** mund të ketë pasoja të dëmshme apo është i kundërligjshëm, menjëherë kërkon që të njëjtin t’a shfuqizojë, në të kundërtën, merr vendim për anulimin apo shfuqizimin e tij.”*
24. Edhe akti nënligjor në implementim të këtij ligji, përkatësisht Rregullorja (QRK) - Nr.17/2024 e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, në nenin 83, par. 1, përcakton: *“Kur Kryeministri konsideron se vendimi i marrë nga zëvendëskryeministri **apo ministri** mund të ketë pasoja të dëmshme, kërkon që zëvendëskryeministri apo ministri t’a ndryshojë, shfuqizojë ose anulojë vendimin brenda dhjetë (10) ditëve të punës. Zbatimi i këtij vendimi pezullohet nga Kryeministri deri kur zëvendëskryeministri apo ministri të vendosë lidhur me vendimin në fjalë.”*

25. Ligji nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në nenin 11, par. 1, nënpar. 1.4, përcakton se ministri: *“Siguron zbatimin e legjislacionit dhe politikave qeveritare nga fushëveprimi i ministrisë.”*

Analiza ligjore dhe konstatimet e Avokatit të Popullit

26. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 21, paragrafët 2 dhe 3, përcakton se Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë dhe se çdokush e ka për detyrë t’i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve. Për të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me kushtetutë, është me rëndësi që ato të zbatohen drejtpërdrejt dhe kjo duhet të jetë e përcaktuar si parim nismëtar i garantimit të të drejtave të njeriut. Ajo që është shumë me rëndësi për realizimin e sundimit të së drejtës dhe funksionimin e shtetit të së drejtës, është çështja nëse një shtet me Kushtetutën e vet garanton të drejtat e njeriut dhe liritë themelore dhe nëse parashikon sistem të mbrojtjes së atyre të drejtave dhe lirive të garantuara. Kjo është me rëndësi pasi për çdo shtet demokratik është i një rëndësie vendimtare si krijimi ashtu edhe realizimi i të drejtave. Këto obligime kushtetuese vlejné edhe për rastin konkret.

Mbrojta nga diskriminimi

27. Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka si qëllim përcaktimin e një kornize të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, shtatzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë.
28. Nuk duhet të ketë asnjë dallim, përjashtim apo preferencë në çfarëdo baze të caktuar si me lart dhe institucionet publike duhet ta kenë parasysh zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë, që në rastin konkret edhe MSh-ja, gjatë vendimmarrjes ta respektojë këtë rregull imperativ, ashtu siç përcaktohet me nenin 3 të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, se nuk do të ketë kurrfarë diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë sipas kuptimit të cilësdo nga bazat e përcaktuara me nenin 1 të këtij Ligji.
29. Organet publike veprojnë në përputhje me Kushtetutën, me legjislacionin në fuqi, si dhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilin janë dhënë këto kompetenca. Parimi i ligjshmërisë, si koncept i së drejtës, ndër të tjerash përcakton se të gjitha aktet e nxjerra nga autoritetet shtetërore duhet të jenë në pajtim me ligjet.
30. Neni 1 i Protokollit 12 [Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit], në paragrafin 1 parashikon: *“Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër”*. Ndërsa, në paragrafin 2, parashikon se: *“Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1.”*

31. Rasti më i mirë për ta sqaruar fushëveprimin e nenit 1 të Protokollit 12 të KEDNJ-së është rasti *Sejdić dhe Finci k. Bosnjës dhe Hercegovinës*:

“Gjykata vëren se ndërsa neni 14 i Konventës ndalon diskriminimin në gëzimin e “të drejtave dhe lirive të përcaktuara në [Konventë]”, neni 1 i Protokollit nr. 12 e zgjeron fushën e mbrojtjes në “çdo të drejtë të përcaktuar me ligj”. Në këtë mënyrë prezanton një ndalim të përgjithshëm të diskriminimit.

Kërkuesit kundërshtuan dispozitat kushtetuese që i bënë ata të papërshtatshëm për t'u zgjedhur në Presidencën e Bosnjës dhe Hercegovinës. Prandaj, nëse zgjedhjet për Presidencën bien apo jo brenda fushëveprimit të nenit 3 të Protokollit nr. 1, kjo ankesë ka të bëjë me një "të drejtë të përcaktuar me ligj" (shih seksionet 1.4 dhe 4.19 të Aktit Zgjedhor 2001 - shih paragrafin 18 më lart) që e bën të zbatueshëm Nenin 1 të Protokollit Nr. 12.....”

32. Madje, sipas Raportit Shpjegues të Protokollit nr. 12, fushëveprimi i mbrojtjes së atij neni ka të bëjë me katër kategori rastesh, në veçanti kur një person diskriminohet:

Në gëzimin e çdo të drejte që i jepet në mënyrë specifike një individ sipas ligjit kombëtar;

Në gëzimin e një të drejte që mund të nxirret nga një detyrim i qartë i një autoriteti publik sipas ligjit kombëtar, domethënë, kur një autoritet publik është i detyruar sipas ligjit kombëtar të sillet në një mënyrë të caktuar;

Nga një autoritet publik në ushtrimin e pushtetit diskrecional (për shembull, dhënien e subvencioneve ose ndihmave);

Nga çdo veprim ose mosveprim tjetër nga një autoritet publik (për shembull, sjellja e oficerëve të zbatimit të ligjit kur kontrollojnë një revoltë). (§ 22 i Raportit shpjegues).

33. Kategoritë e sipërpërmendura zbatohen edhe në rastin *Savez Crkava “Riječ Života” & al. k. Kroacisë*, (pika 104 dhe 105).

34. Rrjedhimisht, nisur nga interpretimi i nenit 1 të Protokollit 12, i cili shtrin fushën e mbrojtjes për *“çdo të drejtë të parashikuar nga ligji”* dhe vendos një ndalim të përgjithshëm të diskriminimit, që nënkupton situata kur çështja bie në fushën e veprimit të një të drejte substanciale të garantuar nga ligji i brendshëm, pra e drejta për të mos u diskriminuar përkitazi me një të drejtë të rregulluar me ligj, në rastin konkret të së drejtës për benificionet e veçanta **për invalidët civilë të luftës**, duke u bazuar në nenin 6 të Ligjit Nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Pjesëtarëve të UÇK-së Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre.

Pritjet legjitime

35. Koncepti i pritjeve legjitime në mbrojtjen e të drejtave subjektive është një koncept gjithëpërfshirës interpretimi në praktikën gjyqësore ndërkombëtare. Rrënjët e parimit të pritjeve legjitime gjenden në të drejtën publike gjermane, parim ky i cili është në përdorim të gjerë nga gjykatat administrative të këtij vendi.

36. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut e ka integruar konceptin e pritjeve legjitime në shqyrtimin e rasteve të ngritura në këtë gjykatë. Sipas jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, (shih rastet *Kopecky v. Slovakia*, Aktgjykimi i datës 28 shtator 2004, para 45-52; *Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke (dec.)*, nr. 39794/98, para 73, *GJEDNJ 2002-VII*), *“pritja legjitime”* duhet të jetë e një natyre

konkrete dhe duhet të bazohet në dispozita ligjore ose në akte ligjore. Në rastin aktual, pritja legjitime e ankuesit bazohet në nenin 6 të Ligjit Nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Pjesëtarëve të UÇK-së, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre.

Përfundim

37. Avokati i Popullit konstaton se Vendimi nr.43/III/2024, i datës 22 mars 2024, i nxjerrë nga MSh-ja, përben diskriminim në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë siç përcaktohet me Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për arsye se vendimi në fjalë përcakton vetëm beneficionet për personat me *statusin e invalidit të luftës së UÇK-së* duke përjashtuar kategorinë e personave me *status të invalidit civil të luftës* edhe pse këto dy kategori i gëzojnë benificonet e njëjtat, të cilat shprehimisht përcaktohen në nenin 6, paragrafi 1.7, të Ligjit Nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Pjesëtarëve të UÇK-së, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre.
38. Po ashtu, edhe Udhëzimi Administrativ nr. 03/2023 për Trajtim Mjekësor Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike, në nenin 10, paragrafi 4, përcakton: “*Personat deri në moshën 18 vjeçare, **personat me status të invalidit të luftës**, anëtarët e ngushtë të familjes së dëshmorëve, personat me aftësi të kufizuara dhe/ose përfitues i ndihmës sociale, viktimat civile të luftës, kompensohen me **100% të vlerës së çmimit referent sipas shtojcës 1 të këtij udhëzimi apo mesatares së çmimit të tri pro faturave për trajtim mjekësor.***” Avokati i Popullit vëren se Ligji Nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Pjesëtarëve të UÇK-së, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre përcakton statusin e dëshmorëve, të të zhdukurve të UÇK-së, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të UÇK-së dhe anëtarët e ngushtë të familjeve të tyre, si dhe statusin dhe të drejtat e viktimave civile, **invalidëve civilë të luftës** dhe familjeve të të marrëve peng dhe të të zhdukurve civilë të luftës. Pra ligji në fjalë përcakton, mes të tjerash, statusin e dy kategorive, siç janë: **invalidët e luftës së UÇK-së** si dhe **invalidët civilë të luftës**.
39. Së fundi, edhe Vendimi nr. 01/194 i Qeverisë së Republikës së Kosovës kishte paraparë mbulimin e trajtimit mjekësor të personave me *status të invalidit të luftës* për qëllim të ndërrimit, mirëmbajtës apo vendosjes së protezave, ndërsa Vendimi nr.43/III/2024, i datës 22 mars 2024, i nxjerrë nga MSh-ja, është në kundërshtim me Ligjin Nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Pjesëtarëve të UÇK-së, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre; me Udhëzimin Administrativ nr. 03/2023 për Trajtim Mjekësor Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike; si dhe në kundërshtim me Vendimin 01/194 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
40. Duke u bazuar në të lartcekurat, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: “[...] *ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.*”; dhe me nenin 16, paragrafi 1.2, të Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit “[...] *ka përgjegjësi të tërheq vëmendjen për rastet kur institucionet e Republikës së Kosovës i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla [...]*”, si dhe “*të rekomandojë [...] nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga Institucionet e Republikës së Kosovës.*” (neni 16, paragrafi 1.6). Prandaj i

REKOMANDON

1. Qeverisë së Republikës së Kosovës:

- *Ta anulojë Vendimin nr.43/III/2024, të datës 22 mars 2024, të nxjerrë nga Ministria e Shëndetësisë.*

2. Ministrisë së Shëndetësisë:

- *Të ndërmarrë masa në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Pjesëtarëve të UÇK-së, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre, për ofrimin e benificioneve të veçanta për invalidët civilë të luftës.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ("Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.") dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit ("Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë."), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,

Naim Qelaj

Avokat i Popullit